VENDIM
Nr. 220, datë 9.4.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS, PËR PUNËSIMIN FITIMPRURËS TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE, OSE POSTEVE KONSULLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për punësimin fitimprurës të anëtarëve të familjes së anëtarëve të misioneve diplomatike, ose posteve konsullore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR PUNËSIMIN FITIMPRURËS TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE, OSE POSTEVE KONSULLORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave i Ukrainës, në vijim të referuara si "Palët Kontraktuese",

me qëllim të krijimit të mekanizmave të rinj për të forcuar marrëdhëniet e tyre diplomatike,

kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

1. Në bazë të reciprocitetit, anëtarët e familjes së anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore të Shtetit dërgues do të kenë të drejtën të angazhohen në profesione fitimprurëse në territorin e Shtetit pritës, në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Respektimi i legjislacionit të brendshëm të Shtetit pritës është i detyrueshëm për një profesion të tillë fitimprurës, i cili është subjekt i rregulloreve të Shtetit pritës.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. "Anëtar i një misioni diplomatik ose posti konsullor" do të thotë një agjent diplomatik ose një anëtar i personelit administrativ dhe teknik të një misioni diplomatik ose zyrtar konsullor ose një

punonjës konsullor i një posti konsullor në Shtetit pritës, i cili nuk është shtetas ose rezident i përhershëm në Shtetin pritës:

2. "Anëtar i familjes së një anëtari të misionit diplomatik ose posti konsullor" nënkupton:

a) burri ose gruaja e një anëtari të një misioni diplomatik ose posti konsullor;

b) fëmijët në ngarkim, të pamartuar, nën moshën 21 vjeç;

c) fëmijët në ngarkim, të pamartuar, nën moshën 25 vjeç, të regjistruar në një universitet ose institucion të arsimit të lartë në Shtetin pritës;

d) persona të tjerë, të njoftuar nga Shteti dërgues si anëtar të familjes dhe të njohur si të tillë nga Shteti pritës.

3. "Punësim fitimprurës" është puna në bazë të kontratës së punës ose me marrëveshje vetëpunësimi. Kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet për anëtarët e familjes së një anëtari të misionit diplomatik ose postit konsullor që punojnë në një mision diplomatik ose post konsullor të Shtetit dërgues, ose një shteti tjetër, ose një mision në një organizatë ndërkombëtare në Shtetin pritës.

4. "Shteti pritës" nënkupton Shtetin e Palës Kontraktuese, në të cilin është akreditуar zyrtarisht një anëtar i misionit diplomatik, ose postit konsullor, dhe ku ndodhet selia e misionit diplomatik, ose posti konsullor i Shtetit pritës.

5. "Shteti dërgues" nënkupton shtetin e Palës Kontraktuese, i cili emëron një anëtar të misionit diplomatik ose postit konsullor, për një detyrë zyrtare në misionin diplomatik ose postin konsullor në Shtetin pritës.

Neni 3

1. Për të marrë një autorizim zyrtar për t'u angazhuar në punësim fitimprurës në Republikën e Shqipërisë, misioni diplomatik, ose posti konsullor i Ukrainës në Republikën e Shqipërisë i dërgon një kërkesë me shkrim Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Kërkesa duhet të përmbajë emrin e anëtarit të familjes, llojin e veprimtarisë me pagesë dhe një përshkrim të shkurtër të saj ose çdo vërtetim tjetër zyrtar të zbatimit të punësimit fitimprurës, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

2. Pas konfirmimin se familjari në fjalë u përshtatet kategorive të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duke marrë parasysh legjislacionin e brendshëm në fuqi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë do të informojë misionin diplomatik ose postin konsullor të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë, me shkrim dhe pa vonesë, se ky anëtar i familjes autorizohet të angazhohet në punësim fitimprurës në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me këtë Marrëveshje.

3. Për të marrë një autorizim zyrtar për t'u angazhuar në punësim fitimprurës në Ukrainë, misioni diplomatik i Republikës së Shqipërisë i dërgon një kërkesë me shkrim Ministrisë së Punëve të Jashtme të Ukrainës. Kërkesa duhet të përmbaje emrin e anëtarit të familjes, llojin e veprimtarisë me pagesë dhe një përshkrim të shkurtër të saj ose çdo vërtetim tjetër zyrtar të zbatimit të punësimit fitimprurës, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Republikës së Ukrainës.

4. Pas konfirmimit se familjari në fjalë u përshtatet kategorive të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duke marrë parasysh legjislacionin e brendshëm në fuqi, Ministria e Punëve të Jashtme e Ukrainës do të informojë misionin diplomatik ose postin konsullor të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, me shkrim dhe pa vonesë, se ky anëtar i familjes autorizohet në angazhohet në punësim fitimprurës në Ukrainë, në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Autorizimi për t'u angazhuar në një punësim fitimprurës, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojë, kur:

a) përfituesi i tij pushon së pasuri statusin e një anëtari të familjes së një anëtari të një misioni diplomatik ose konsullor, sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje;

b) ndërpritet kryerja e punësimit fitimprurës;

c) është ndërprerë detyra zyrtare e një anëtari të misionit diplomatik ose konsullor, ku përfituesi është anëtar i familjes.

Neni 5

1. Anëtarët e familjes që angazhohen në punësim fitimprurës, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil ose administrativ i Shtetit pritës, sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike ose Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore ose çdo rregull tjetër e zbatueshme e së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me të gjitha çështjet që rrjedhin nga një punësim i tillë fitimprurës.

2. Nëse një anëtar i familjes që gëzon imunitet nga juridiksioni penal, sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike ose Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore ose çdo rregull tjetër e zbatueshme e së drejtës ndërkombëtare, dispozitat që vendosin një imunitet të tillë do të zbatohen në lidhje me çdo veprim ose mosveprim që ka ardhur nga angazhimi në një punësim të tillë fitimprurës.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni penal nuk shtrihet në ekzekutimin e një vendimi. Për heqjen e imunitetit në lidhje me ekzekutimin e një vendimi parashikohet kryerja e një kërkese të veçantë për këtë qëllim. Në raste të tilla, Shteti dërgues do të shqyrtojë me kujdes kërkesën për heqjen e këtij imuniteti.

Neni 6

1. Asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i jep të drejte anëtarit të familjes së një anëtari të një misioni diplomatik ose posti konsullor për t'u angazhuar në një punësim fitimprurës, që, sipas legjislacionit të Shtetit pritës, mund të kryhet vetëm nga shtetasit e tij, ose që lidhet me sigurinë kombëtare.

2. Kjo Marrëveshje nuk nënkupton njohjen automatike të provave të kualifikimit formal të marra jashtë vendit. Një njohje e tillë do të jepet vetëm në përputhje me rregullat e zbatueshme për këtë çështje në Shtetin pritës. Në rast të veprimtarisë profesionale që kërkon kualifikim të veçantë në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, anëtari i familjes së një anëtari të një misioni diplomatik ose posti konsullor nuk do të përjashtohet nga përmbushja e kërkesave të njëjta që zbatohen për shtetasit e shtetit pritës. Kjo Marrëveshje nuk nënkupton njohjen e diplomave dhe të gradave të studimeve ndërmjet Shteteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Anëtari i familjes së një anëtari të një misioni diplomatik ose posti konsullor, që angazhohet në punësim fitimprurës, sipas kësaj Marrëveshjeje, do t'u nënshtrohet rregullave tatimore, të mbrojtjes shoqërore dhe shëndetësore në Shtetin pritës, për të gjitha çështjet e lidhura me punësimin fitimprurës në Shtetin pritës.

Neni 8

Anëtari i familjes së një anëtari të një misioni diplomatik ose posti konsullor, që angazhohet në punësim fitimprurës në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese nuk do të ketë të drejtën e përjashtimit nga çdo kërkese e brendshme, procedurë ose tarifë që mund të zbatohet zakonisht për një punësim të tillë fitimprurës.

Neni 9

1. Çdo mosmarrëveshje që lind për interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhjet nëpërmjet kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve Kontraktuese.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me Marrëveshje reciproke me shkrim ndërmjet Palëve Kontraktuese. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë (1) të muajit të dytë (2) pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të Palëve Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike, për plotësimin e kërkesave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me kusht që një njoftim me shkrim t'i jepet Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, përfundimi do të ketë efekt 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më 28 shkurt 2024, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, ukrainase dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR KABINETIN E MINISTRAVE TË UKRAINËS
Igli Hasani	**Dmytro Kuleba**